



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 40 dhe nenit 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi ..... nga ....., Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

### VENDIM

Procedura për lëndën nr. 12-2076 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-2076/1 me datë 28.03.2019, dorëzuar nga parashtruesi ..... nga .....,  
**NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-2076 nga viti 2019.

Lënda me numër 12-2076 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

### SQARIM

Lënda me numër 12-2076 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12-2076/1 me datë 28.03.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtruesi ..... nga .....

Në denoncim flitet për akuza për parregullësi gjatë zgjedhjes së prokurorëve në Prokurorinë themelore publike – Shkup, të zgjedhur gjatë periudhën prej viteve 2008 deri 2011.

Gjatë rishikimi të rastit të lëndës, KSHPK i merr parasyshë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të përcaktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri në Këshillin e prokurorëve publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut për informacione dhe të dhëna në lidhje me rastin e lëndës. Me kërkesë të Komisionit shtetëror është dorëzuar lajmërim me informacionet e kërkuara me shtojcë dokumentacion dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë me të cilin disponon për rastin e lëndës, nga ana e KSHPK është caktuar gjendja faktike vijuese:

- Akuzat e lëndës ka të bëjnë me dyshime për parregullsi gjatë zgjedhjes së prokurorëve në Prokurorinë themelore publike Shkup, të zgjedhur në periudhën e viteve 2008 deri 2011. Akuzat konkrete kan të bëjnë me zgjedhjen e prokurorit ..... në PThP Shkup në kohën kur bashkëshorti i saj ..... ka qenë deputet në përbërjeme partisë VMRO-DPMNE nga viti 2008 deri në vitin 2011. Në shtojcë të denoncimit janë dorëzuar një pjesë nga stenogramet e senacës së Kuvendit të RM të mbajtur me datë 26.04.2012 në të cilën parashtruesi mendon se ka indicje për zgjedhje të parregullt edhe të një prokurori tjetër (.....).

Parashtruesi i denoncimit si arsyje për denoncimin e vet thekson se në vitin 2018 në PThP Shkup ka dërguar kallëzim penal kundër 39 personave fizik dhe juridik për ndërtim pa

të drejtë, keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimeve, larje të parave dhe mashtrime, me çka lënda u nda për punë tek prokurori i lartëpërmendur nga të gjithë 170 prokurorët në nivel të RMV. Ai nuk është i kënaqur nga veprimi i prokurori të përmendur, dyshon në zgjedhjen e tij për prokuror dhe mendon se i njëjti ka qenë i parregullt dhe dyshon në mënyrën e shpërndarjes së lëndëve të denoncimeve të cilët kan arritur deri në Prokurorinë themelore publike në Shkup.

- Me datë 05.07.2019, me kërkesë të KSHPK është marrë përgjigje nga Këshilli i prokurorëve publik me të cilën informojnë se në periudhën prej viteve 2008 deri 2011, në Prokurorinë themelore publike Shkup, nga ana e Këshillit të prokurorëve publik, për tërë atë periudhë, gjithsej janë zgjedhur 56 (pesëdhjet e gjashtë) prokuror publik. Në numrin më të madh të rasteve bëhet fjalë për zgjedhje dhe transformim të mandatit në mandat pa kufizim të kohëzgjatjes së mandatit. Në atë periudhë, më konkretish, në senacën e Këshillit të mabjtur me datë 12.11.2009, për prokuror publik në Prokurorinë themelore publike Shkup është zgjedhur ....., e cila edhe më tej e kryen funksionin e njëjtë.

Në fund të informimit theksohet se në përputhje me autorizimet dhe kompetencat e Këshillit të prokurorëve publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Këshilli nuk ka autorizime për hulumtim të vendimeve nga përbërjet paraprake të Këshillit, dhe as të vendimeve të përbërjes aktuale të Këshillit. Këshilli mund vetëm që, në procedurë disiplinore duke vepruar për ankesë të dorëzuar në diskutim për statusin e prokurorëve publik, dhe duke vendosur në pikëpamje të kryerjes joprofesionale dhe joadekuate të funksionit të prokurorit publik.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të caktuar, KSHPK konstaton se nuk janë vërtetuar akuzat e lëndës për parregullsi gjatë zgjedhje së prokurorëve, dhe njëherit KSHPK nuk ka kompetenca për kontrollim të punës së prokurorisë publike kompetente në lidhje me mënyrën e shpërndarjes së lëndëve dhe kryerje së funksionit të prokurorëve publik kompetent, me çka vlerëson se Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën të ndërpritet kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Në bazë të tërë kësaj të shënuar më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Dorëzuar deri tek: Arkiva dhe Parashtruesi  
Pas përfundimit të KSHPK  
Përpunoi: J. C., këshilltarë  
Miratoi: G. T. anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР  
PARANDALIM ТЁ КОРРУПСИОНИТ  
Kryetarë: Biljana Ivanovska**